

# DREJTORIA ARSIMORE E FILADELFIAS

ZYRA E REGJISTRIMIT DHE PRANIMIT TE NXENËSVE

## Proçesi i Zgjedhjes së Shkollës Viti 2015-2016

Çfarë duhet bërë nga Nxënësit e Drejtorisë Arsimore

### Faza Përgatitore



- ✓ Rishikoni rekordet mësimore më të fundit të nxënësit. Kjo përfshin, por nuk kufizohet me notat, frekuentimin, sjelljen dhe rezultatet e testeve të standardizuara.
- ✓ Kërkoni për shkollat ku nxënësi mund të jetë i interesuar për të aplikuar (vizitoni panairët e shkollave, kërkoni në internet, planifikoni vizitë në shkollë, përdorni sa më tepër burime të mundshme për njohjen e shkollave).
- ✓ Për shkollat me kritere pranimi, (Pranim Special, Shkollat ose Programet nga i Gjithë Qyteti) sigurohuni të krahasoni rezultatet e nxënësit, me kriteret e pranimit.

### Dërgimi i Aplikimit

- ✓ Nëpërmjet Portalit të Nxënësit – Do t'ju duhet numri i ID së nxënësit dhe fjalëkalimi.
- ✓ Nëpërmjet Portalit Prindi & Familja - Prindërit duhet të regjistrohen, që të kenë akses online për aplikimin e Zgjedhjes së Shkollës.
- ✓ Nxënësit dhe familjet do të kenë mundësi të bëjnë ndryshime në aplikim deri në datën 13 Nëntor, ora 5:00 PM.
- ✓ **KUJTESË:** Drejtoria Arsimore do të pranojë si të mirëqenë ndryshimin e **fundit** në aplikimin e nxënësit.
- ✓ Të gjitha njoftimet do të bëhen nëpërmjet Portaleve të Nxënësit dhe Prindit, përfshirë vendimin e shkollës (Miratim, Mosmiratim, Listë Pritjeje).

### Dërgimi i Dokumentave Plotësuese

- ✓ Aplikantët e Drejtorisë Arsimore të Filadelfias **duhet** të punojnë me këshilltarët e shkollave të tyre për plotësimin e shëmbujve të eseve/shkrimeve dhe/ose letrave të rekomandimit, aty ku ju kërkohen.
- ✓ Në rast se fëmija juaj ka një plan IEP, 504Plan, ose merr shërbime të ESOL, ju lutemi kontaktoni me këshilltarin tuaj të shkollës dhe diskutoni rreth Proçesit të Mbrojtjes LeGare.

### Në vazhdimësi

- ✓ Kontaktoni shkollat e aplikimit tuaj, që të mësoni për datat dhe orën e intervistave, dëgjimeve dhe vizitave të hapura.



### ?Pyetje?

Kontaktoni Zyrën e Regjistrimit dhe Pranimet të Nxënësit në:  
[schoolselect@philasd.org](mailto:schoolselect@philasd.org), ose telefononi 215-400-4290.